RELACION TEKNIK

"RIKUALIFIKIMI I PARKUT INDUSTRIAL KUÇOVE"

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

-HYRJE

Parku i propozuar në qytetin e kuçovës ndodhet në afërsi të qendrës së qytetit.Në pjesën perëndimore kufizohet me stadiumin e kucovës nga rruga "Stanisllav Zuber".Në pjesën jugore kufizohet me zonën industriale nga rruga "Naftëtari".Në pjesën lindore me rrugën e re dhe në atë veriore rruga "5 Qershori".Vetë sheshi më përpara ka qënë zonë industriale.

Pozicioni në rajon



Foto të gjëndjes aktuale

Duke analizuar gjëndjen aktuale vëmë re që në këtë zonë disa nga strukturat e objekteve të mëparshme i kanë rezistuar kohës kurse disa të tjera janë degraduar.Gjithashtu gjelbërimi i lartë është eliminuar i tëri.Në këtë hapsirë ka mbetur vetëm gjelbërim i ulët tip shkurre.

- **Propozimi per Parkun e Ri**

Koncepti

Duke analizuar gjëndjen ekzistuese të sheshit u mendua të krijohej një lidhje e kulturës së vjetër që ka pas qyteti në lidhje me industrinë e rëndë dhe të re-së.

- **Pikat lidhese me qytetin dhe ruajtja e elementeve arkitektonik**



Nga analiza e gjëndjes ekzistuese e zonës u mendua të ruhen disa elemente të cilat kanë vlera arkitektonike por edhe kulturore për qytetin.

- **Nderthurja e tyre ne sheshin e ndertimit**



sipas kufizimit që ka kjo zone rreth saj u mendua që dhe vet zonimi i tij ti përshtatej ketij kufizimi.Në pjesën perëndimore duke qënë se sheshi kufizohet nga stadiumi u mendua që zonat sportive të cilat do të ketë parku të pozicionohen në atë krahë pranë stadiumit duke krijuar dhe një lidhje vizuale me vet stadiumin.Gjithashtu në pjesën jugore ky shesh kufizohet nga objektet industriale të cilat nga degradimi nuk paraqesin ndonjë pamje shumë estetike.Për këtë arsye në këtë krahë të kësaj zone është menduar gjelbërim i lartë për të eliminuar sado pak pamjen e atyre godinave.Pjesa veri-lindore është krahu më i shfrytëzuar nga banorët duke qënë se dhe ajo pjesë ka afërsi me qendrën e qytetit.Për këtë arsye është menduar që hyrja kryesore e parkut do të jetë në këtë krahë duke qënë se dhe në pjesën veriore janë pozicionuar hapsirat tregtare e bar-kafet.

- **Levizja rastesore e njeriut**

Që në historinë e tij parku është projektuar në funksion të njeriut dhe të kërkesave të tij.Ndjenja e të qënit i lirë dhe kjo ndjenjë perceptohet vetëm në natyrë.Për këtë arsye është menduar që lëvizjet rreth parkut të ri do të kenë si bazë lëvizjen rastësore të njeiut për të shmangur monotoninë e rrugës.Gjithashtu rruga kryesore do të ketë si qëllim lidhjen e njeriut me

elementët arkitektonik të ruajtur në shesh.Për këtë arsye kjo rrugë që do të projektohet do të kaloj rreth e rrotull këtyre objekteve.Një tjetër element i rëndësishëm është dhe vazhdimësia e rrugës,aty ku fillon aty mbaron.



Albania

- **Krijimi i rrugeve kryesore te kalimit**

Përvec rrugës kryesore të parkut është menduar krijimi i disa rrugëve të tjera dytësore të cilat do të lidhin zonat e tjera rreth e rrotull parkut në mënyrë që të ketë akses dhe në krahet e tjera.Gjithashtu ato do të ndihmojnë dhe për lidhjen e zonave të vet parkut brenda.

- **Zonimi funksional**

duke qënë se vet sipërfaqja e sheshit eshte 31401m2 pjesën më të vogël të saj do ta ketë sheshi qëndror i cili do të jetë një hapsirë që do të mund të kryhen aktivitete e festa sezonale.Kjo hapsirë është propozuar 6822m2.

Është menduar një hapsirë për fëmijët sipas moshave të ndryshme.Kjo sipërfaqe do të jetë 4070m2.Zona sportive e cila do të përmbajë tre fusha të mëdha,një për futboll një për volejboll dhe një tenis do të ketë një sipërfaqe prej 2293m2.Kurse pjesa tjetër do të jetë për funksione të përgjithshme si workshope,rekreacione,piknik,vrap,yoga etj.

- **Masterplani**

Në masterplan shikohet më e detajuar jo vetëm pozicionimi i elementeve kryesor sipas funksioneve përkatës por edhe integrimi me elementë të tjerë natyror që duhet të ketë një park.Duke qënë se objektet me vlerë arkitektonike do të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në idenë e këtij parku është menduar një integrim i tyre me natyrën dhe me vet parkun.Që në hyrjen e tij ndodhet kulla e vjetër që ka pas për funksion ftohjen e tecit.Si element me rëndësi jo vetëm nga historia por edhe nga madhësia e gjatësia e saj ai vihet re.Për këtë arsye është bërë një lidhje e saj me ujin dhe gjelbërimin për ta rritur akoma më shumë vlerën e tij.Element tjetër i rëndësishëm në këtë park është oxhaku i cili është objekti më i lartë në këtë shesh.Me formën e tij të hollë dhe finese dhe me materialin e veshur me tulla ai paraqitet si objekti më i bukur i këtij parku.Pranë tij ndodhen dy skelete të mbetura të ish kullave të tjera të ftohjes.Këto dy elemente janë menduar të ruhen për tu integruar me parkun duke i dhënë funksion.Është menduar që ato ti shërbejnë zonës së fëmijëve.Dhe elementi i fundit që do të ruhet do të jetë fasada e një fabrike në pjesën perëndimore të parkut.Ruajtja e kësaj fasade është menduar për ti dhënë pak më gjallëri atij krahut dhe gjithashtu është menduar që në këtë fasadë do pozicionohen fushat sportive e cila në një pjesë të ditës do të krijojë hijëzim për këto fusha.Në

sheshin qëndror të këtij parku janë vendosur disa basene ujore dhe disa fasha gjelberimi.Përvec stolave të cilat nuk do të mungojnë në të gjithë gjatësine e rrugëve të parkut është menduar dhe krijimi i një mini amfiteatri i cili do të ketë funksionin e kryerjes së aktiviteteve të ndryshme në momente të caktuara po që në pjesën më të madhe të ditëve do të ketë thjeshtë funksion qëndrim dhe relaksi për qytetarët.

E rëndësishme në park janë detajet urbane që do të implementohen në to të cilat e plotësojnë atë jo vetëm në aspektin funksional por edhe estetik.Janë propozuar disa detaje të cilat do të vendosen në pjesë të caktuar sipas zonimit përkatës.

- **Zona e femijëve**

- **Sheshi qëndror**

- **Hapsirat e tjera rekreative**

- **Imazhe 3-dimensionale të parkut**



ARKONSTUDIO SHPK

LIC : 6996/4

ADMINISTRATORI : ING . KRENAR DILA

RELACION TEKNIK

Sistemi i furnizimit me uje per ujitje

Hyrje

Sistemi i furnizimit me ujë per ujitje ne kete rast konsiston ne marrjen e ujit nga rrjeti ekzistues i qytetit dhe per ta shperndare ate ne menyre qe te tille qe ne cdo zone te gjelberuar qe eshte parshikuar ne projekt te kete aksesin per tu ujit manualisht.

Duke qene se nuk kemi pasur informacion ne lidhj me rrjetin ekzistues te furnizimit me uje te zones atehere eshte mare ne kosiderate nje pike lidhje me rrjetin e cila eshte pare me leverdi per shperndarje te njetrajteshme dhe duke krijuar mundesine e vetrrjedhies se ujit ne zone. Duhet pasur parasysh qe gjate zbatimit kjo pike te pershtatet me rrjetin ezkistues por duhet qe te respektohen dimensionet dhe fakti i krijimit te mundesise se vetrrjedhies se ujit per shkak te disnivelit qe ka terreni.

Ne kete menyre eshte kompozuar nje rrjet ne te gjithe zonen ne te cilin jane poziconuara puseta te vogla te cilat jane vendosur saracineska neper te cilat punonjesit do te lidhin nje tubacion fleksibel me gjatesi 30m me te cilin do te mund te ujisin siperfaqet e gjelberuara. Kushtesohet gjatesia 30m per shkak se distanca nderjet pusetave eshte vendosur e tille me nje distance peraferisht 30m nga njera tjetra.

Open Procurement Albania

Pergjate kesaj linje eshte parashikuar edhe lidhja e ambientit teknik te basenit ujor me linjen e furnizimit me uje.

Baseni ujor

Baseni ujor eshte parashikuar qe te jete i pajisur me ambientin teknik, linjat e shperndarejs, hundezat e hedhies se ujit si dhe pileta e shkarkimit.
Ambienti teknik eshte i kompozuar nga linja e marjes se ujit nga rrjeti i ri qe do te ndertohet, nepermjet te cilit do te furnizohet me uje baseni, pompat e qarkullimit te ujit, linjat e dergimit dhe te kthimit te ujit nga baseni, pompa e drenazhimit ne rast avarie.

Linjat e shperndarjes perfshijne linjen e furnizimit me uje te basenit e cila ka pike kontrolli ne ambientin teknik , linjat e qarkullimit e ujit nepermjet pompave te qarkullimit. Materiali i ketyre linjave eshte parashikuar te jete PP per linjat e shkarkimit si dhe PE per linjat e dergimit.

Elementet e basenit jane hundezat te cilat bejne te mundur hedhien e ujti dhe qarkullimin e tij, piletat e kthejne ujin ne ambientin teknik si dhe piletat te cilat e shkarkojne ujin ne rast pastrimi apo avarie.
Eshte e domosdoshme qe baseni i ujit te pastrohet dhe te ti behen sherbime maksimumi nje here ne 6 muaj per te ruajitur gjendien funksionale dhe te pastertise sa me gjate.

ARKONSTUDIO

Dimensionimi

Dimensionimi dhe projektimi i te gjithe komponenteve dhe aksesoreve te sistemit te furnizimit dhe te shperndarjes te ujit eshte realizuar duke marre ne konsiderate elementet e meposhtem:

- Percaktimi i prurjes nominale dhe dimensionimi i tubove;
- Dimensionimi i tubacioneve magjistrale;
- Prurja totale nominale;
- Presioni i punes;
- Shpejtesia max. e qarkullimit te ujit;

Tubacionet e shpërndarjes

Tubo e ketij sistemi jane ndare ne funsion te materialit te tyre.

Tubo Polyetileni jane perzgjedhur ne perputhje me standarte internacionale te kualitetit ISO 9001 or DIN 53457 (Quality and Test Requirements for pipes). Keto tubo jane vendosur ne kanale dhe kane veti te shkelqyera si dhe karshi agjenteve kimike, stabilitet te larte termik, peshe te ulet, humbje te ulta presioni, te thjeshte ne mirembajtje per riparime dhe transport, te thjeshte ne instalim dhe nje jetegjatesi prej mbi 50 vjet .
Vetite termofizike te tubove PE-HD jane me poshte si vijon :

- Densiteti 0,940 g /cm^3
- Temperatura deri ne 110 grade Celsius
- Percjellshmeria termike 0.35 W/mK
- Koeficienti i zgjerimit termik linear 1,4 x 0,0001 K $^{-1}$
- Moduli i elasticitetit ne 20 grade 670 N/mm^2
- Ashpersia e tubit 0.007 mm

Tubot PE-HD do te perdoren te zhveshur ne rastin kur do te transportojne uje te ftohte dhe te termoizoluar (PE espanso + shtrese) ne rastin kur do te transportojne uje te ngrohte.

Te gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tubacioneve duhet te behen dhe sipas kerkesave teknike te projektit. Nje katalog me te dhenat teknike, çertifikatat e cilesise, origjines se materialit, garancia minimale prej 1 vit dhe çertifikata e testimit te bere nga prodhuesi, do t'i jepet per shqyrtim supervizorit te investittorit per nje aprovim para se te vendoset ne objekt.

Open Procurement Albania

Sistemi i shkarkimit te ujrave te shiut

Hyrje

Rrjeti i shkarkimit te ujerave te shiut do te ndertohet i ri, pasi per shkak te ndryshimit te destinacionit te sheshit nga zone industrial ne park eshte pare e nevojshme qe rrjetet e mbledhies se ujrave te shiut te ndertohet reja, si dhe rrjete te drenazhimit te ujrave nenetokesore dhe atyre te ujitjes.
Rrjeti I mbledhjes se ujrave siperfaqesore do te fokusohet ne zonat ne te cilat shtresa siperfaqesore eshte e padepertuehsme nga uji dhe si e tille eshte zona qendore e shetitores si dhe ne fushat e sportit te cilat do te ndertohen te reja .
Ky rrjet eshte parashikuar te mbledhe te gjitha ujerat siperfaqesore dhe eshte parashikuar qe te shkarkojne ne rrjetin ekzistues te rruges se qytetit.

Rjeti I mbledhies se ujrave nentokesore dhe siperfaqesore dhe eshte parashikuar qe te shtrihen ne zonen e cila do te lihet e gjelberuar dhe per te cilen eshte parashikuar qe te ujitet here pas here nga stafi perkates I bashkise dhe si e tille ky rrjet do te vendoset ne thellesine 1 meter nga niveli I gjelberimit per te mbledhur sic permendem me siper ujrat e ujitjes, atyre te shiut si dhe ujrat nentokesore nese ka. Ky rrjet eshte parashikuar te mbledhe te gjitha ujerat siperfaqesore dhe nentokesore dhe eshte parashikuar qe te shkarkojne ne rrjetin ekzistues te rruges se qytetit.

Llogaritja e dimensioneve te rrjetit te shkarkimit te ujerave te shiut eshte bere duke patur parasysh te dhenat e paraqitura te references per zonen dhe siguria llogaritese e diametrave te tubave eshte marre 25 % per kolektoret kryesore edhe 40 % per kolektoret sekondare.

Diametrat e tubave jane llogaritur me programet perkatese duke patur parasysh te dhenat e mesiperme.

Duke qene se nuk kemi pasur informacione ne dispozicion per rrjete ekzistuese qe mund te ndodhen ne rrugen qe rrethon zonen atehere duhet pasur parsaysh qe gjate zbatimit te pershtate pozicioni I pusetave kryesore te rrjetit te bdrenshem te zones me pusetat ekzistuese te rrjetit te rruges, duke pasur parasysh jo vete pozicionin por edhe permasat e pusetes ekzistuese duke shmangur permbytje te mundeshme apo keqfunksionim te rrjetit te ri qe do te ndertohet.

Materialet e tubave

Per shkarkimet e ujrave do te perdoren tuba plastike PP I rrudhosur (polipropilen i termostabilizuar ne temperature te larta) qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove). Ata jane disenjuar ne perputhje me standartin EN 12056.

Keto tuba duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti, instalim te thjeshte dhe te shpejte si dhe jetegjatesi mbi 30 vjet.

Open Procurement Albania

Rakorderite per tubot e shkarkimit

Per lidhjen e tubave te shkarkimit me njeri tjetrin si dhe me pusetat e shkarkimit do te perdoren rakorderite perkatese me material plastik PP, qe plotesojne te gjitha kerkesat e cilesise sipas standartit EN 1451 (Kerkesa per testimin dhe kualitetin tubove).

Keto rakorderi (pjese bashkuese) duhet te sigurojne rezistence ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi, transporti dhe instalim, te thjeshte dhe te shpejte.

Permasat (diametri) e tyre do te jene ne funksion te sasise llogaritese te ujit te shiut, shpejtesise se levizjes se ujit dhe diametrave te tubave perkates. Gjate llogaritjeve, shpejtesia e levizjes se ujit duhet te merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes do te jete 0.5-0.8 e seksionit te tubit.

Diametri dhe spesori i tyre duhet te jene sipas te dhenave ne vizatimet teknike. Te dhenat mbi diametrin e jashtem, gjatesite, presionin, emrin e prodhuesit, standardit qe i referohen, viti i prodhimit, etj. duhet te jepen te stampuara ne çdo rakorderi.

Diametri i rakorderive duhet te jete i njejte me diametrin e tubit te shkarkimit ku do te lidhet dhe ne asnje menyre me i vogel se tubi me i madh i dergimit te ujrave te ndotura qe lidhet me te. Ne rastet e ndryshimit te diametrit te tubave te shkarkimit dhe te dergimit, rakorderite duhet t'i pershtaten secilit prej tyre.

Pusetat e ujrave te shiut

Te gjitha tipet e pusetave mund te jene me mure te tilla me elemente te parafabrikuara betoni, ose me beton te derdhur ne vend.

Materiali nga i cili eshte prodhuar si korniza ashtu edhe kapaku duhet te jene kapak gize grille ose me kapak betoni per pusetat e rrjetit te ujrave nentokesore.
Pusetat duhet te plotesojne kerkesat e meposhtme teknike:

- Ngarkesen e mbajtjes, te jashtme;
- Presionin e dheut;
- Presionin e ujit.

Dimensionet e pusetave kalkulohen ne funksion te prurjeve jane percaktuar nga projektuesi ne vizatimet perkatese. Gjithashtu edhe dimensionet e kolektoreve qe shkarkojne ujrat te shiut jane kalkuluar dhe dimensionuar ne funksion te prurjeve dhe materiali i tyre eshte perzgjedhur PP i rudhosur ne siperfaqen e jashteme dhe i lemuar ne ate te brendshme me dimensione qe variojne nga 200-400 mm.

RELACION TEKNIK
PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

RIKUALIFIKIMI I PARKUT INDUSTRIAL KUCOVE

Ndriçimi rrugor

Ndricuesat jane parashikuar Me një dizenjo me element të stilit klasik, me një kombinim të përkryer të materialit gizë me qelqin për ti shtuar stilin , finesën , elegancën ,duke llogaritur lartësinë dhe fuqinë në raport me gjerësinë e rrugës dhe hapësirat e sheshit.

Linja elektrike eshte me trase nëntokësore ku të vendoset tub plastik fleksibël me dy shtresa me ∅=110 mm për kalimin e kabllit të furnizimit dhe tub metalik me ∅=1400 mm për intersektim rruge.

Pusetat jane prej betoni me përmasa brenda përbrenda 40x40x40cm me kapak plastike. Distanca ndërmjet pusetave eshte 12 m larg njëra tjetrës dhe jane vendosur mbrapa çdo shtylle për tu mbrojtur nga dëmtimet. Panelet e komandimit jane vendosur me komandim sauteri me fotoelementë.
Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat ekzistuese të zonës. Në këto kabina do të instalohen panelet e ndricimit rrugor të cilat do ushqehen me ura të veçanta nga tranformatori ekzistues. Në kabinë do behet dhe vendosja e matësve të energjisë. Do të behet tokëzimi i shtyllave të ndriçimit.

Jane respektuar normat Europiane të performances së ndriçimit EN 13201:
Ndriçuesit jane me kontroll smart në mënyrë që të rregullohet intesniteti i ndriçimit sipas orëve dhe fluksit të përdorimit të rrugës. Përzgjedhja e normës së ndriçimit sipas PD CEN/TR 13201-1:2014. Performanca e ndriçimit eshte loogaritur sipas përdoruesve të rrugës (makina, biçikleta, këmbësor). Jane percaktuar Indikatorët e performancës së energjisë 1. treguesi i densitetit të fuqisë metrike (PDI) DP (i matur në Ë/(lx·m2) dhe treguesit vjetor të konsumit të energjisë (AECI) DE (të matur në (Ëh)/m2. Ne baze te llojit te rrugës sipas standartit EN 13201 urbane, rurale, parësore, dytësore, në eshte percaktuar dhe lloji dhe intensiteti i ndriçimit. Jetëgjatësia e ndriçuesit "Led" sipas standartit IEC 62722-2-1Temperature e ndriçimit eshte sipas standartit nga 2500 deri 5000 Kelvin, në mënyrë që të evitohet efekti i ndotjes (light pollution).

1- OBJEKTI I PUNIMEVE

Ky projekt permban percaktime dhe orientime per furnizimin dhe venien ne pune te impianteve elektrike te nevojshme per instalimet elektrike te objektit.

Objekt i ketij relacioni teknik jane edhe percaktimet per normat teknike qe jane perdorur ne projektimin e impianteve elektrike te ndare si me poshte.

- Praqitja (vizatimet) e projektit.
- Zgjedhjet dhe procedura per rrjetin elektrik.
- Cilesite e materialeve te zgjedhura.
- Impianti I tokezimit

- **PARAQITJA E PROJEKTIT**

Projekti paraqitet nepermjet vizatimeve te planeve te percaktuara, te skemave te paneleve te vecanta dhe skemes se furnizimit nga TU.

Zgjedhja dhe llogaritja e pajisjeve ne kete project eshte bere sipas normave te CEI dhe kushteve teknike ISO-9001.

Gjate projektimit ne menyre rigoroze eshte respektuar projekti arkitektonik, ne baze te te cilit jane vendosur elementet e pajisjeve elektrike me simbolet perkatese.

Ne vecanti gjate projektimit eshte bere kujdes ne zgjedhjen e pajisjeve duke marre ne konsiderate mbrojtjen e pajisjeve nga lidhjet me token, lidhjet me token, si dhe mbrojtjen e perdoruesve nga rryma elektrike.

Sistemi I regjimit te percjelesit te neutrit eshte zgjedhur Sistemi TNS e mbi kete baze jane projektuar si panelet e energjise. Mbrojtja me token realizohet me automat diferencial Id=0.03A dhe In=variable.

- **CILESITE E MATERIALEVE**

Te gjitha materialet dhe aparatet e perzgjedhura qe do te perdoren te jene sipas normave te CEI. Rekomandohet qe te gjitha pajisjet qe do teperdoren te jene prodhime me targen CE qe te plotesoje kushtet e percaktuara ne normat teknike europiane.

- **Tubat mbrojtes dhe kutite shperndarese**

Ne te gjitha rastet percjellesit dhe kabllot e perdorura duhet te jene te mbrojtura te futur ne tubo plastike te serise se rende. Seksioni do te jete ne varesi te numrit te percjellesve te future ne to dhe seksionit te percjellesit. Diametri I tubit duhet te jete jo me pak se 20mm2. Ne te gjitha rastet diametri I tubit duhet te jete te pakten 1.5 here diametrin e tufes se percjellesave apo te kabllove te futur ne te.

Kutite shperndarese jane zgjedhur te tilla qe te mundesojne futjen e tubave, lidhjen e percjellesve dhe garantimin e mbylljes se sigurte te kutise. Permasat e kutive shperndarese jane zgjedhur te tilla qe te qe te mundesojne shperndarjen e nxehtesise qe prodhohet ne brendesi te tyre.

Percjellesat dhe kabllot

Per instalimin e rrjetit elektrik jane zgjedhur tippet e meposhtme te percjellesave dhe kabllove

N07V-K percjelles nje polar I izoluar me PVC. Ky percjelles instalohet I future ne tuba plastik

FROR 450/700 kabell fleksibel shume polar qe perdoret ne instalimin e pajisjeve te sherbimeve etj.

Open Procurement Albania

FG7R 06/1 kv percjelles njepolar I I zoluar me gome te kualitetit G7 me guajne e PVC. Perdoret si percjelles I fuqise.

- **Izolimi I kabllove** jane zgjedhur te kategorise se pare per tu pershtatur me tensionin kundrejt tokes dhe tension nominal (Uo/U) 450/700 V. kabllot qe do te perdoren per sistemin e sinjalizimit dhe komandimit do te kene parametrat 350/450 V.

- **Ngjyra e kabllove** qe do te perdoren ne instalimin e impiantit elektrik do te jene te unifikuara me ngjyrat dhe normat CEI. Pra per percjelles neutri do te perdoret ngjyra blu, per percjelles tokezimi ngjyra verdhe-jeshile dhe per percjelles faze ngjyrat e zeze, gri, kafe, **kuqe.**

- **Seksioni I percjellesve dhe kabllove** do te zgjidhet ne menyre qe te plotesoje kushtin e ngrojes se lejuar poer plotesim te te humbjes se tensionit deri ne 4% nga burimi I ushqimit deri ne kuadrin e fundit te instaluar. Seksione nominale do te jene

    - 1.5mm2 per qarqet e ndricimit
    - 2.5mm2 per qarqet me fuqi deri ne 2.5 kw
    - 4mm2 per qarqet me fuqi deri ne 4 kw

  Seksioni I neutrit ne qarqert e fuqise ne te gjitha rastet do te jete I barabarte me seksionin e fazes. Edhe seksioni I mbrojtjes (PE) do te jete I I barabarte me seksionin e fazes

  Mbrojtja e linjave.

  Si rregull ne te gjitha rastet qe furnizojne kuadrot e objektit do te jene me pese percjellesa. Ne panelet e fuqise se kateve sistemi I mbrojtjes do te jete me automat diferencial I cili do te jete ryesor, ndersa cdo linje do te mbrohet edhe me automat magneto-termik.

  Per linjat me seksion 1.5mm2 automati I mbrojtjes do te jete I tipit C dhe rryme nominale 10A.
  Per linjat me seksion 2.5mm2 automati I mbrojtjes do te jete I tipit C dhe me rryme nominale 16A
  Per linjat me seksion 4mm2 automati I mbrojtjes do te jete I tipit C dhe me rryme nominale 20A.

  Fuqia ckycese e automateve do te jete nga 4.5-35KA me Id=0.3Ma

- **IMPIANTI I TOKEZIMIT**

Impianti I tokezimit do te realizohet me elektroda tokezimi, tubo xingato me D=35mm2 dhe L=1.5m. Ky impiant do te lidhet dhe me box-in e matesit te energjise si dhe me kuadrin elektrik

Open Procurement Albania

kryesor me percjelles CU-35m2 I zhveshur. Numri I elektrodave do te jete aq sa te arrihet rezistenca e tokezimit < 10 Ohm.

Impianti I tokezimit do te jete ekuipotencial. Do te lidhen me kete impiant gjithe pajisjet apo materialet metalike te instaluara . Kjo duhet zbatuar me korrektesi sipas zgjidhjes ne vizatimin perkates.

ING. LINDITA GJEKA

Open Procurement Albania